



Pranimar / Dorezuar Prilimjenal/Prodato Received/Delivered	21. 04	2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKM840K	1923/2021		1/4	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Anr.146/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Arben Mehmeti -anëtarë me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër Anr.146/2021 të datës 16.03.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: Rruga “Ymer Prizreni”, nr.33, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 21.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.146/2021 e datës 16.03.2021, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi sipas ndryshimit dhe Plotësimit të akt emërimit të datës 02.12.2019 i punësuar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në pozitën “Udhëheqës në laboratorin e vëllimit dhe rrjedhës në Agjencinë e Meteorologjisë së Kosovës”, i pakënaqur me institucionin punëdhënës për shkak të mos realizimit të shtesave në pagë sipas vendimit nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 1183/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 19.03.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Më datë 26.03.2021 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka dërguar përgjigjen në ankesë me dosjen e bashkangjitur të lëndës me numër protokollit:1420/2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 16.03.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; E-mailin e datës 16.03.2021 dërguar nga për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej 4 (katër) faqesh; Plotësim dhe Ndryshim i Akt Emërimit i datës 02.12.20219; Vendimin e datës 12.02.2016 me numër Nr.02Ref.46; Përshkrimin e detyrave të punës për ankuesin; Shkresën e datës 01.01.2016; Diplomën e ankuesit të datës 21.07.2003 me numër:94; Shtojca e Diplomës me Nr.08/1588 e datës 24.10.2019; Shkresën e datës 09.12.20219 me numër prot:9874; Certifikatën e datës 13.05.2013 me cod:BEL010; Certifikatën e datës 15.05.2013 me cod:G2AS-990; Certifikatën e datës 22.05.2013 me cod:G2HY-990; Çertifikatën e datës 26.01.2015; Certifikatën e datës 26.06.2015; Certifikatën e datës 31.08.2015; Certifikatën e datës 28.11.2017 lëshuar nga Euromet; Çertifikatën e datës 23.02.2018 lëshuar nga Euromet; Certifikatën e datës 22.01.2016; Certifikatën e datës 28.11.2017 20.06.2019; Çertifikatën e datës 25.09.2018; Certifikatën e datës 17.07.2012; Certifikatën e datës 22.06.2010; Çertifikatën e datës 07.12.2018; Çertifikatën e datës 17.09.2015; Çertifikatën e datës 23.01.20215; Çertifikatën e datës 06.02.2015; Çertifikatën e datës 02.10.2015; Çertifikatën e datës 05.10.2019; Draft Raportin e muajit tetor 2016 nga Portuguese Institute for Quality; Final Raport i muajit nëntor 2016 lëshuar nga Portuguese Institute for Quality; Raporti final i muajit prill 2020 nga Euromet projekts 1395 me shkresat e bashkangjitura; kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 19.03.2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 26.03.2021 me numër protokoll 1420/2021; kërkesën e bërë përmes emaili të datës 25.03.2021 nga për E-mailin e datës 12.03.2021 dërguar për me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 (tre) faqesh; Listën e pagave të ankuesit e datës 26.03.2021;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, duke u bazuar në kompetencat e tij dhe pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit Agim Xhuraj, **është e pa bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon për njohje të plotë të shtesës në pagë sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, ka gjetur se ankuesi së bashku me kolegët e Agjencisë së Meteorologjisë të Kosovës me datë 25.03.2021 përmes e-mailit kanë parashtruar kërkesë tek Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore për shtesa në pagë sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës edhe pse paraprakisht e kanë pranuar njoftimin e datës 12.03.2021 me e-mailin e bashkangjitur të datës 12.03.2021 dërguar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme me arsyetimin se: "... *Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB ende nuk e ka themeluar Komisionin që do të merrej me shqyrtimin e kërkesave të institucioneve të SHCK-së që kanë të bëjnë me realizimin e shtesave mbi pagën bazë të çfarëdo natyre qofshin ato, pas themelimit të këtij Komisioni, institucionet e SHCK-së do të marrin përgjigje në të gjitha rastet që kanë parashtruar kërkesë...*", andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore ka parashtruar kërkesë për informata pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB se a ju takojnë zyrtarëve të MTI-së pagesa shtesë mbi pagën bazë sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.146/2021**

Flakron GASHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

